4.Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- | | |
|--------------------------------|---|
| 23. Njoftimi i Fituesit | 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese. |
|--------------------------------|---|

- | | |
|--|--|
| 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës | <p>1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.</p> <p>2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.</p> |
|--|--|

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;

- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP.

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

EKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës Ekonomike në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafiku i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmblidhjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1- Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë ne pronesi ose me qira një servis, ku të disponoje, makineri e pajisje të nevojshme për realizimin e kontratës si vijon:

-Makineri teknologjike si, torno me shtrat mbi 3 m për riparim eskavatori, trapano magnetike, radiale, bareno.

-Makineri për barrinim.

-Makineri për presim tubosh.

-Ratifik për ratifikim testatash dhe pjesë pompash dhe motorri.

-Të ketë vinç ure 10-12 ton.

*Për të gjitha pajisjet e mësipërme, duhet të paraqiten foto.

2-Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Operatori Ekonomik është i detyruar të kryej riparim – shërbimin dhe furnizimin me pjesë këmbimi të eskavatorve dhe mjeteve të transportit.

- Shërbimi për ndërrimin dhe riparimin e pjesëve të dëmtuara ose me defekt etj, do të bëhet me pjesë origjinale (ose ekuivalente me to) dhe jo me pjesë të modifikuara, të riparuar ose të përdorura.

- Pajisjet dhe pjesët e dëmtuara pas ndërrimit, riparimit do të dorëzohen në magazinën e Bashkisë Divjakë.

- Për të gjitha pjesët e ndërrimit duhet të bëhet furnizimi me to sipas specifikimeve dhe llojit perkates të çdo mjeti dhe sjellja e tyre në magazinën e Bashkisë Divjake nga ana e Operatorit Ekonomik.

- Riparimet dhe shërbimet që do të ofrohen nga operatori ekonomik, duhet të kenë garanci jo më pak se 6-gjashtë muaj.

- Çdo ofertues duhet të japë çmimet e riparimit dhe shërbimit detyruesisht për të gjitha zerat e tabelës së kryerjes së shërbimit.

- Afati i përfundimit të kontratës është 8 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

- Në rast të mosplotësimit të kohës së garancisë nga cilësia e keqe e pjesëve të montuara ose punës jo të mirë për montimin e tyre, perseritet riparimi duke filluar garancinë që nga ajo ditë. Në rastet e perseritjes së të njëjtit defekt, apo defekteve të reja, që mund të kenë ardhur

si rezultat e pasoje i riparimit te defektit me mangesi ose pjese te perdorura, riparimet do te kryhen nga Operatori Ekonomik pa pagese.

- Kontrolli teknik i pajisjeve per sherbim qe do te kryhet do te behet nga perfaqesuesit e Drejtorise se Infrastruktures, e cila ben dhe miratimin e sherbimeve qe do te kryhen, te pasqyruara ne nje situacion te firmosur nga te dyja palet dhe qe do shoqeroje faturen e fiskalizimit te kryerjes se sherbimit.

- Dokumentat do te jene te vulosura dhe pa korrigjim.

- Koha mesatare e riparimit te nje eskavatori do jete **7** dite pune dhe per nje mjet transporti do të jetë **4** ditë pune.

- Të gjitha pjeset e mesiperme te jene ne perputhje me kerkesat e katalogjeve te cdo ekskavatori dhe mjeti transporti.

- Gjate periudhes se garancise te mos kete rrjedhje apo renie te fuqise se punes se mjetit.

- Ne riparimet e nyjeve te mos kete ndryshime konstruktive qe ndikojne ne afatin e sherbimit.

- Pjeset e perdorura per riparimin e mjeteve te jene te tipit perkates, pas riparimit te mos kete difekte dhe zhurma jo normale.

- Riparimi i defekteve te paisjeve apo zevendesimi eshte detyrim i operatorit ekonomik qe merr persiper kryerjen e sherbimit. Te gjitha sherbimet per nderrimin e pjeseve te ndryshme do te zevendesohen me pjese origjinale ose ekuivalente me to.

- Kryerja e sherbimit, sidomos ato emergjente do te realizohet ne cdo kohe, sipas kerkeses se argumentuar te Autoritetit Kontraktor.

- Kryerja e sherbimit, riparimit, zevendesimi pjeseve etj, do te behet me mjetet e operatorit ekonomik, sipas kerkeses se argumentuar te perfaqesueseve te Drejtorise se Infrastruktures te Bashkise Divjake.

- Vendi dhe kryerja e sherbimeve: Ne objektet ku punojne mjetet dhe ne oficen e kontraktorit, sipas nevojave te argumentuara per kryerjen e riparim – sherbimit te mjeteve.

- Vendi dhe dorezimi sherbimeve nga pala kontraktore do te jete ofcina e pales kontraktore ose vendi ku dote kryhet riparim – sherbimi i mjetit perkates.

- Dorezimi i sherbimeve dhe mallrave do te behet ne vendet e percaktuara si me siper, ne prani te grupit te specialisteve te Drejtorise se Infrastruktures te Bashkise Divjake.

Shenim: Pjeset e kembimit dhe materialet e kerkuara duhet te jene kampione te njejte sipas katalogut te cdo mjeti.

Specifikimet teknike u hartuan nga specialisti i fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Mjeti: Fadromë

Modeli: Caterpillar 428

Viti i prodhimit: 1989

Nr.shasie: 3DJ000123

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	F.V.Set gominash piston të kovës para	copë	2
2	F.V.Set gominash pistoni të kovës mbrapa	copë	1
3	F.V.Rrip motorri	copë	1
4	F.V.Rrip dinamoje	copë	1
5	F.V.Stopa sinjali	copë	2
6	F.V.Tubo presioni hidraulike	copë	2
7	F.V.Filtër ajri	copë	2
8	F.V.Filtër nafte	copë	2
9	F.V.Filtër vaji	copë	2
10	F.V.Filtër vaji hidraulik	copë	2
11	F.V.Filtër vaj kambio	copë	2
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti: Eskavator
Marka: BENAT
Modeli: 3.16 me goma
Viti i prodhimit: 1992
Nr.shasie: 4R5250

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Riparim gjeneratori	shërbim	1
2	Riparim i sistemit elektrik	shërbim	1
3	F.V.Filtër ajri	copë	1
4	F.V.Filtër nafte	copë	1
5	F.V.Filtër vaji	copë	1
6	F.V.Filtër vaj kambio	copë	1
7	F.V.Filtër vaj hidraulik	copë	1

Mjeti: Eskavator me zinxhir
Marka: Volvo
Modeli: EC220D
Viti i prodhimit: 2016
Nr. shasie: VCE220DJ00280429

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	F.V.Rrip dinamo	copë	1
2	F.V.Rrota e zinxhirit të shasisë	copë	2
3	Bateri 12V 180A	copë	2
4	F.V.Filtër ajri	copë	3
5	F.V.Parafiltër ajri	copë	3
6	F.V.Filtër nafte	copë	3
7	F.V.Parafiltër nafte	copë	3
8	F.V.Filtër vaji	copë	3
9	F.V.Filtër vaj hidraulik	copë	3
10	F.V.Parafiltër vaj hidraulik	copë	3
11	F.V.Element filtër hidraulik	copë	3

Mjeti: Eskavator me zinxhir

Marka: Volvo

Modeli: EC220D

Viti i prodhimit: 2016

Nr.shasie: VCE220DK00280395

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	F.V.Rrip dinamo	copë	1
2	F.V.Rota e zinxhirit të shasisë	copë	2
3	F.V.Filtër ajri	copë	3
4	F.V.Parafiltër ajri	copë	3
5	F.V.Filtër naftë	copë	3
6	F.V.Parafiltër naftë	copë	3
7	F.V.Filtër vaji	copë	3
8	F.V.Filtër vaji hidraulik	copë	3
9	F.V.Parafiltër vaji hidraulik	copë	3
10	F.V.Element filtër hidraulik	copë	3

Mjeti: Kamion

Modeli: AstraBM-201ËSH

Viti i prodhimit: 1981

Nr.shasie: BM201MT15413

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	F.v.Ventilator ajri	copë	1
2	F.v.Motorrino	copë	1
3	Dadiçek	copë	16
4	F.V. Daulle frenash	copë	4
5	F.V.Këmbë motorri	copë	2
6	F.V.Këmbë kambio	copë	1
7	F.V.Koka moco	copë	2
8	F.V.Amortizatore të parë	copë	2
9	F.V.Rrip motorri set komplet +kuzhinet	Set	1
10	F.V.Rrip dinamoje	copë	1
11	Riparim kambio	shërbim	1
12	Riparim sistem hidraulik	shërbim	1
13	F.V.Goma 12R20	copë	4
14	F.V.Valvul filtri i kompresorit të ajrit	copë	1
15	F.V.Filter naftë	copë	2
16	F.V.Filter vaj motorri	copë	2

17	F.V.Filter ajri	copë	2
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti: Kamion

Modeli: Scania 112

Viti i prodhimit:1986

Nr.shasie:YS2RE6X4Z01106536

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	F.V.Koka paraleli	copë	2
2	F.V.Koka moco	copë	2
3	F.V.Rrip motorri set komplet +kuzhinet	Set	1
4	F.V.Rrip dinamoje	copë	1
5	F.V.Krahe stabilizatori	copë	2
6	Riparim Centralino e mjetit	shërbim	1
7	F.V Pompe Uji	copë	1
8	F.V.Amortizator para	copë	2
9	F.V.Këmbë motorri	copë	2
10	F.V.Këmbë kambio	copë	1
11	Fener para	copë	2
12	Stopa sinjali	copë	4
13	F.V.Kushineta qendrore	copë	1
14	F.V.Gomina shtange	copë	4
15	F.v.Shperndares ajri	copë	1
16	Filter nafte	copë	2
17	Filter vaj motorri	copë	2
18	Filter ajri	copë	2
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti: Kamion
Modeli: Mercedes- Benz 16-19
Viti i prodhimit:1982
Nr.shasie:385026142040017

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	F.V.Koka moco	copë	2
2	F.V.Kryq transmisioni	copë	1
3	F.V.Rrip dinamoje	copë	1
4	F.V.Këmbë motorri	copë	2
5	F.V.Këmbë kambio	copë	1
6	F.V. Termostat uji	copë	1
7	F.V.Kushineta të rrotave të përparme	copë	2
8	F.V.Kushineta të rrotave të pasme	copë	4
9	F.V.Kushineta tensionuese të rripit	copë	1
10	Riparim xhenerike	shërbim	1
11	Riparim I grupit te timonit	shërbim	1
12	Filter nafte	copë	1
13	Filter vaj motorri	copë	1
13	Filter ajri	copë	1
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti: Fadromë
Modeli :JCB 3C
Viti i prodhimit:1997
Nr.shasie:0452346

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	F.V.Koke paraleli	copë	2
2	Riparim gjeneratori	shërbim	1
3	Riparim I kapjes se mekanizmit koves para	shërbim	1
4	Riparim I pompes hidraulike	shërbim	1
5	Tubo hidraulike	copë	4
6	Bateri 12V 100A	copë	1
7	Riparim I koves mbrapa	shërbim	1
8	F.V.Set gominash piston te koves	Set	1

	para		
9	F.V.Skrapamento	copë	1
10	F.V.Set gominash pistonit te koves mbrapa	Set	1
11	F.v. Filter ajri	copë	2
12	F.v. Parafilter ajri	copë	2
13	F.v. Filter nafte	copë	2
14	F.v. Filter vaji	copë	2
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti: Kamion

Marka: IVECO FIAT

Modeli :DALY

Viti i prodhimit:2004

Nr.shasie:ZCFC50A0005512590

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Riparim i Sistemit te Ajrit	shërbim	1
2	Riparim Motorino	shërbim	1
3	Riparim I sistemit elektrik	shërbim	1
4	F.V. Amortizator	copë	2
5	F.V. Suport amortizatori	copë	2
6	F.V.Rrip motorri set komplet +kuzhinet	Set	1
7	F.V.Rrip dinamoje	copë	1
8	F.V.Krahe stabilizatori	copë	2
9	F.V.Tubo presioni te larte bokull+rekorde	copë	2
10	F.V.Celsa elektrik komandues	Set	1
11	F.V.Gomina shtange	copë	4
12	F.V.Sprucator dhe Injektor	copë	4
13	F.V.Këmbë motorri	copë	2
14	F.V.Këmbë kambio	copë	1
15	F.V.Kushinete rrotash	copë	2
16	F.V.lampe feneri	copë	2
17	F.V.lampe sinjali	copë	2
18	F.V.Filter nafte	copë	2

19	F.V.Filter vaji	copë	2
20	F.V.Filter ajri	copë	2
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti:Autoveturë

Marka:MERCEDES-BENZ

Modeli :E280CDI

Viti i prodhimit:2005

Nr.shasie:WDB2110231A722995

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	F.V.Rip motorri set komplet + kuzhinet	Set	1
2	F.V.Rip dinamoje	copë	1
3	Kopje Çeles komandues	copë	2
4	Riparim brave (hapje/mbyllje)	shërbim	2
5	Paketa elektrike dritat e shkurta	copë	2
6	Paketa elektrike dritat e gjata	copë	2
7	F.V Pompe Alkoli	copë	1
8	F.V. Pompe Uji	copë	1
9	F.V. Dadicek	copë	4
10	F.V.Parakolp	copë	1
11	F.V.llampe feneri	copë	2
12	F.V.llampe sinjali	copë	4
13	F.V.Këmbë motorri	copë	2
14	F.V.Këmbë kambio	copë	1
15	Filter ajri	copë	3
16	Filter Kondicioneri	copë	3
17	Filter kamjo	copë	3
18	Filter vaj motorri	copë	3
19	Filter nafte	copë	3
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti:Foristrad
Marka:Mitsubishi
Modeli : K60T
Viti i prodhimit:2000
Nr.shasie:MMBJNK740YD036555

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	F.V.Rrip motorri set komplet +kuzhinet	Set	1
2	F.V.Rrip dinamoje	copë	1
3	F.V.Këmbë motorri	copë	2
4	F.V.Këmbë kambio	copë	1
5	Riparim ridoto	shërbim	1
6	F.V.Pasqyre	copë	1
7	F.V.Kushineta të rrotave të përparme	copë	2
8	F.V.Kushineta të rrotave të pasme	copë	2
9	F.V.Kryq grupi timoni	copë	1
10	F.V.llumpe feneri	copë	2
11	F.V.llumpe sinjali	copë	4
12	Filter ajri	copë	3
13	Filter Kondicioneri	copë	3
14	Filter kamjo	copë	3
15	Filter vaj motorri	copë	3
16	Filter naftë	copë	3
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti:Grejder
Marka:Fiatallis
Modeli : 91U
Viti i prodhimit:1985
Nr.shasie: 91U00397

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Riparim Gjeneratori	shërbim	1
2	Riparim Pompe naftë	shërbim	1
3	Riparim I sistemit te frenimit	shërbim	1
4	Riparim i ingranazhit te koronës	shërbim	1
5	F.V. Bateri 12V 100 Ah	shërbim	1

6	F.V Pompë Uji	copë	1
7	F.V.Tubo presioni	copë	4
8	F.v. Filtër hidraulik BT267	copë	1
9	F.v. Filtër vaj motorri BT 348	copë	1
10	F.v. Filtër nafte	copë	1
11	F.v . Filtër ajri	copë	1
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti: Zetor JOHN DEERE

Modeli: 7700

Viti i prodhimit:1995

Nr.shasie: RW7700H003180

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	F.V.Koka grasatimi	copë	10
2	F.V.Thika freze(Trinxhe)	copë	20
3	F.V. Pompë nafte	copë	1
4	F.V.llampë feneri	copë	2
5	F.V.Goma 20.8 R 42 Tobulare	copë	2
6	F.V.Rrip motorri	copë	1
7	F.v.Regjister per krahet e hidraulikut të zetorit	copë	2
8	F.v.Bateri 12 V 100 Ah	copë	2
9	F.V.Tubo presioni	copë	4
10	F.v.Filtër hidraulik	copë	2
11	F.v.Parafiltër hidraulik		2
12	F.v.Filtër vaj motorri	copë	2
13	F.v.Filtër nafte	copë	2
14	F.v.Parafiltër nafte	copë	2
15	F.v.Filtër ajri	copë	2
16	F.v.Parafiltër ajri	copë	2
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti: Rimorkio për transport mallrash

Marka: WACKENHUT

Viti i prodhimit:1979

Nr.shasie: 37981016

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	F.V.(Goma 265/70 R17.5 + disk) peshe tubolare	copë	2
2	F.V.Goma 245/70 R17.5 peshe tubolare	copë	4
3	Zinxhire + regjistër për transportimin(sigurimin) e mjeteve	ml	20
4	Regjistër për fiksimin e rampave	copë	2
5	Dadicek + rrondele	copë	16
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti: Makina Teknologjike

Marka:SKANIA

Viti i prodhimit:2005

Nr.shasie: YS2P6X20002007137

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Goma	Cope	4
2	Goma karrelë	Cope	1
3	Filtra komplet	Cope	1
4	Diskofren para	Cope	2
5	Ferrotë komplet para mbrapa	Cope	4
6	Riparim pistonash të vegjël të makinerisë	Cope	4
7	Riparim Pistoni i madh që shtyn mbeturinat	Cope	1
8	Riparim Pompa Hidraulike	Cope	1
9	Llampa komplet	Cope	1
10	Pasqyre komplet krahu anësor i shoferit	Cope	1
11	Koka paralele	Cope	1
12	Koka Zbare	Cope	2
13	Pakete Kambio	Cope	1
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			

Shuma me tvsh

Mjeti: Makina Teknologjike

Marka:DAF

Modeli: AG7 Bardhe

Viti i prodhimit:2010

Nr.shasie: XLRAG75PC0E882964

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Goma 315/80/22.5	copë	6
2	Filtra komplet	copë	2
3	Riparim pistoni madh i lopatës që shtyn mbeturinat	shërbim	1
4	Riparim pistonash anësore të lopatës qe mbledh mbeturinat	shërbim	2
5	Riparim pistonash të vegjel	shërbim	4
6	Ferota komplet para mbrapa	copë	4
7	Tambure komplet	copë	4
8	Jastek ajri	copë	2
9	Tub presioni vaj hidraulik	copë	1
10	Set nofullash	copë	4
11	Gomina komplet para mbrapa	copë	1
12	Llamba komplet	copë	6
13	Motorrino e re	copë	1
14	Koka paralele	copë	2
15	Koka zbare	copë	2
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti: Makina Teknologjike**Marka:DAF****Modeli: AG7 Kuqe****Viti i prodhimit:2011****Nr.shasie: XLRAG75PC0E888342**

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Goma 315/80/22.5	copë	6
2	Filtra komplet	copë	1
3	Bateri 180A	copë	2
4	Ferrota komplet para mbrapa	copë	4
5	Riparim piston lopatë që mbledh mbeturinat	shërbim	1
6	Riparim pistonat e vegjël të makinerisë	shërbim	2
7	Jastek ajri	copë	2
8	Tambure komplet	copë	4
9	Motorrino e re	copë	1
10	Set nofullash	copë	2
11	Llampa komplet	copë	6
12	Koka paralele	copë	2
13	Koka zbare	copë	2
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti:Kamioncine**Marka:FORD****Modeli: TRANSIT****Viti i prodhimit:2002****Nr.shasie: WF0CXXGBFC2L48558**

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Goma 195 /75 /16C	copë	2
2	Ferrota komplet	copë	4
3	Dinamo	copë	1
4	Koka paralele	copë	2
5	Koka zbare	copë	2
6	Bateri 100A	copë	1
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			

Shuma me tvsh

Mjeti:Kamioncine

Marka: IVECO

Modeli: C3572

Viti i prodhimit:1999

Nr.shasie: ZCFC3572005228747

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Goma 195 / 75 / R16	copë	2
2	Fenerët para	copë	2
3	Ferrotë komplet	copë	4
4	Llamba komplet	copë	4
5	Tambure mbrapa	copë	2
6	Koka paralele	copë	2
7	Koka zbare	copë	2
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti:Kamioncine

Marka: Ford

Modeli:Transit BXX

Viti i prodhimit:1992

Nr.shasie: WF0BXXGBVBMU62357

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Goma 195 / 75 / R16	copë	2
2	Ferrotë komplet	copë	4
3	Tambure	copë	2
4	Llamba komplet	copë	4
5	Koka paralele	copë	2
6	Koka zbare	copë	2
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Mjeti: Kamioncine veteshkarkuese

Marka: Nisan

Viti i prodhimit: 2012

Nr.shasie: VWADPTF24C3145376

Nr	Emërtimi	Nësia	Sasia
1	Goma	copë	4
2	Filtra komplet	copë	1
3	Ferota komplet	copë	4
4	Koka paraleli	copë	2
5	Koka zbare	copë	2
6	Llampa	copë	2
7	Freksion i ri	copë	1
8	Riparim pompa hidraulikut të kazanit	shërbim	1
Shuma pa tvsh			
Tvsh 20%			
Shuma me tvsh			

Marka: Mercedes benz

Modeli: 1222

Viti i prodhimit: 1988

Nr.shasie: WDB6152 6415264444

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	
1	Riparim i sistemit hidraulik	shërbim	1	
Shuma pa tvsh				
Tvsh 20%				
Shuma me tvsh				

Marka: Mercedes benz

Modeli: 11-20

Viti i prodhimit: 1991

Nr.shasie: WDB67718315557650

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	
1	Riparim i pompës centrifugale	shërbim	1	
Shuma pa tvsh				
Tvsh 20%				
Shuma me tvsh				

***Shënim:** Në respektim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.

Afatet e lëvrimit: Afati i dorëzimit të mallit është 8 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit"

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2022, 2023 dhe 2024 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e Ligjit nr.9632, datë

30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Shenim: *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, i ndryshuar dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësura me origjinalin”.*

2.4 Kapaciteti teknik:

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Përsa i perket aftësisë teknike e profesionale, vlerësojme si kriteret teknike të nevojshme, për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kriteret si më poshtë:

3.1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë ne pronesi ose me qira një servis .Për të vërtetuar pronësinë e servisit, operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë, dokumentacion që vërteton pronësinë (Certifikatë për vërtetim pronësie). Për kontrata të qirasë, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë kontratën përkatëse të qirasë me objekt dhe afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Për të vërtetuar pronësinë e servisit, operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë, dokumentacion që vërteton pronësinë (Certifikatë për vërtetim pronësie). Për kontrata të qirasë, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë kontratën përkatëse të qirasë me objekt dhe afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, I ndryshuar dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti

kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

3.2 Operatori ekonomik pjesëmarres, duhet të paraqesë një vertetim nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 5 (pesë) punonjës, shoqëruar me Listepagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatim mbi të ardhurat nga punësimi (Formulari numer E-SIG 025/a), të disponuara dhe konfirmuara elektronikisht nga sistemi.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike Listepagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi (Formulari numer E-SIG 025/a), të disponuara dhe konfirmuara elektronikisht nga sistemi, duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit)

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

3.3 Operatoret ekonomike pjesëmarres, duhet të kenë në stafin e tyre jo më pak se 5 (pesë) punonjës, nga të cilët:

-1 punonjës mekanik, për kryerjen e çmontimit – riparimit – montimit të mekanizmave, sistemeve të mjeteve të makinerisë së rënde dhe mjeteve të transportit të paraqitura në preventiv.

- 1 punonjës elektroaut, për kryerjen e çmontimit – riparimit – montimit të impianteve elektrike të mjeteve të makinerisë së rënde dhe mjeteve të transportit të paraqitura në preventiv.

- 1 punonjës saldator, për kryerjen e çmontimit – riparimit – montimit me saldim të mekanizmave, sistemeve të mjeteve të makinerisë së rënde dhe mjeteve të transportit të paraqitura në preventiv.

-1 punonjës xhenerik , per kryerjen e çmontimit – riparimit – montimit te pjeseve xhenerike te mjeteve te makinerise se rende dhe mjeteve te transportit te paraqitura ne preventiv.

-1 punonjës Ing.Mekanik , per te ndjekur kryerjen kryerjen e riparim-sherbimeve me cilesi te mjeteve te makinerise se rende dhe mjeteve te transportit te paraqitura ne preventiv.

Per permbushjen e ketij kriteri, Operatori ekonomik duhet te kete ne Listepagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi punonjesit e mesiperm, si edhe per secilin prej tyre duhet te paraqitet:

-Kontrata e punes, deshmite profesionale te leshuara nga institucione shteterore ose private te akredituara ne Republiken e Shqiperise, kjo per arsye se te gjitha riparim – sherbimet e mjeteve te makinerise se rende dhe mjeteve te transportit, kerkojne cilesi dhe specialiste perkates, me pervojte pune dhe besueshmeri ne kryerjen e riparim – sherbimit te kerkuar.

Autoriteti kontraktor përpara shpalljes së kualifikimit të operatoreve ekonomik ka të drejtën e verifikimit te informacioni te dhene nga operatori ofertues per plotesimin e ketij kriteri kualifikues.

3.4 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të disponoje certifikatat e meposhteme:

